

DEKLARATË PËR SHTYP

MBI PARIMET UDHËZUESE TË AKADEMIVE TË TË RINJVE

Halle (Saale), Gjermani - Akademitë e Shkencave e të Rinjve në mbarë globin kanë hartuar një deklaratë mbi parimet e tyre thelbësore të veprimtarisë, të titulluar "Deklarata mbi Parimet Udhëzuese të Akademive të të Rinjve". Nënshkruesit – përfshirë edhe Akademinë e të Rinjve të Shqipërisë – ndjejnë fuqimisht se kanë një rol kryesor për të ndihmuar në zgjidhjen e sfidave globale dhe synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e botës përmes zbulimit shkencor.

Deklarata është produkt i drejtpërdrejtë i Takimit të Katërt Botëror të Akademive të të Rinjve, që u zhvillua në korrik 2019, në Da Nang, Vietnam, nga Akademia pritëse e të Rinjve të Vietnamit, në bashkëorganizim me Global Young Academy (GYA).

Me mbështetjen e GYA, rrjeti i Akademive të të Rinjve vazhdon të rritet, nga një numër i vogël në vitin 2014, sot numëron më shumë se 40 në të gjitha rajonet globale. Me këto numra në rritje, nevoja për një konsensus mbi parimet dhe vlerat thelbësore që karakterizojnë Akademitë e të Rinjve është bërë e dukshme, në drejtim të vazhdimin të ndërtimit të këtij komuniteti aktiv dhe në rritje.

Të koordinuar nga GYA, pothuajse 40 Akademi të të Rinjve janë bashkuar gjatë muajve të fundit nga e gjithë bota për të hartuar një seri parimesh udhëzuese, si vijon: Përsosmëria, Diversiteti & Përfshirja, Përgjegjësia, Dëshmia të bazuara në njohuri, Pavarësia & Transparenca dhe Integritetit.

Deklarata përfshin disa thirrje për veprim, përfshirë një që i drejtohet studiuesve të rinj në të gjithë botën për të krijuar Akademi të të Rinjve në vendet ku nuk ekzistojnë. Thirrjet e tjera i adresohen Akademive ekzistuese të të Rinjve, që të vazhdojnë të harmonizojnë veprimet e tyre me parimet thelbësore të sapohartuara si dhe ndaj Akademive Shkencore "Senior" për të punuar dhe mbështetur homologët e tyre të Akademisë së të Rinjve.

Deklarata u shpall në Forumin Botëror të Shkencave në Budapest, Hungari, më 20 nëntor 2019.

Deklarata është në dispozicion këtu: <https://globalyoungacademy.net/declaration-young-academies-2019/>

Media contact: GYA Press Officer, James.Curtiss@globalyoungacademy.net

#YoungAcademy

#WWMYA2019

RRETH AKADEMISË BOTËRORE TË TË RINJVE (GLOBAL YOUNG ACADEMY) (GYA).

Global Young Academy (GYA) u themelua në vitin 2010 dhe synon t'u japë zë shkencëtarëve të rinj në të gjithë botën. GYA fuqizon studiuesit e rinj për të udhëhequr dialogun ndërkombëtar, ndërdisiplinor dhe mes brezash, duke zhvilluar dhe mobilizuar talentin nga gjashtë kontinente. Qëllimi i GYA është të motivojë gjithëpërfshirjen në vendimmarrjen globale. Anëtarët zgjidhen për ekselencën e tyre të demonstruar në arritjet shkencore dhe përkushtimin ndaj shërbimit. Aktualisht, ka 200 anëtarë dhe 258 alumni nga 83 vende. GYA e ka selinë e saj në Akademinë Kombëtare të Shkencave Leopoldina të Gjermanisë dhe fondet fillestare i ka siguruar nga Fondacioni Volkswagen. Që nga viti 2014, GYA financohet nga Ministria Federale Gjermane e Arsimit dhe Kërkimit (BMBF) dhe është mbështetur nga Partneriteti NdërAkademik (IAP) dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë.

GLOBAL YOUNG ACADEMY DHE RRJETI I AKADEMIVE KOMBËTARE TË TË RINJVE

Akademitë e të Rinjve janë akademi të formuara nga shkencëtarë dhe studiues të rinj që gjenden në stadin e fillimit dhe të mesëm të karrierës, të cilët janë përzgjedhur përgjithësisht për ekselencën dhe impaktin e kërkimeve të tyre shkencore si dhe për përkushtimin për shërbim. Akademitë e të Rinjve funksionojnë si zëri i shkencëtarëve të rinj për promovimin e çështjeve me rëndësi për shoqërinë dhe për shkencëtarët e rinj.

Një nga qëllimet kryesore të GYA është të mbështesë krijimin dhe zhvillimin e Akademive Kombëtare të të Rinjve (NYA) dhe organeve të ngjashme, të bashkëpunojë me ta dhe të sigurojë mundësi për rrjetëzim dhe forcim të kapaciteteve. Tashmë, në mbarë botën ekzistojnë më shumë se 40 NYA dhe mbi 10 organe të ngjashme - shumë prej tyre janë themeluar me mbështetje nga GYA dhe anëtarët e saj. Rrjeti global i Akademive të të Rinjve vazhdon të rritet në mënyrë dinamike, me krijimin e akoma më shumë NYA-ve në të gjithë botën. Gjashtë Akademi të reja priten të themelohen në muajt e ardhshëm (shiko <https://globalyoungacademy.net/national-young-akademitë/>).

GYA është një mjet lehtësues aktiv dhe mbështetës i anëtarëve të saj dhe partnerëve të NYA në të gjithë botën.